

PhD Cand. Aurora Bega¹

Problematikat e transmetimit si mungesë e financimeve në televizionet lokale në qytetin e Gjirokastrës

Abstrakt: Prezantim Poster

Në kushtet e dixhitalizimit të mediave në Shqipëri dhe zhvillimit të vullshëm të medias sociale, si një medium i rëndësishëm që po zëvendëson median tradicionale, duket se mediat lokale kanë mbetur disi në hije.

Qyteti i Gjirokastrës mbulohet nga tre televizione kryesore: televizion publik lokal TVGJ, dhe dy televizione lokale Alpo dhe Channel 7 të cilat prodhojnë lajme për të gjithë zonën dhe rrethinat e saj.

Këto televizione kanë si burim të ardhurash vetëm reklamat dhe të ardhurat e realizuara janë të pamjaftueshme për të pasur staf të plotë dhe të kualifikuar si edhe mundësi për të prodhuar emisione cilësore që i diferencojnë nga njëra-tjetra dhe i afrojnë më afër televizioneve kombëtare.

Një tjetër problematikë e televizione lokale në qytetin e Gjirokastrës është formimi akademik i stafit që punon në këto media. Pjesa më e madhe e gazetarëve dhe stafit teknik nuk kanë studiuar në fushat që përkojnë me pozicionin e tyre të punës çka cenon profesionalizmin e tyre.

Ky punim synon të mbledh të dhëna në tre televizionet lokale duke sjellë kështu një paraqitje të plotë të problemeve të financimit, prodhimit mediatic dhe statusit profesional të gazetarit në televizionet lokale të qytetit të Gjirokastrës.

Fjalët kyç: media lokale, transmetim, kapacitete fizike, financim, gazetar lokal

¹Universiteti I Tiranës, departamenti I gazetarisë dhe I komunikimit,
aurora_bega@yahoo.com

Pyetjakerkimoreqeshtronpunimi: A ndikojnë problemet financiare në televizionet lokale të qytetit të Gjirokastrës në cilësinë e prodhimeve televizive të tyre?

Hipoteza: Mungesa e financimeve, stafit të specializuar dhe subvencionimeve nga bashkia Gjirokastrë për mediat lokale ka çuar në nivele amatore prodhimet dhe transmetimet e tyre televizive duke ia humbur kështu medias lokale misionin kryesor të saj.

Metodologjia: Metoda e përdorur për mbledhjen e të dhënave është metoda cilësore e cila konsiston në analizën e prodhimeve televizive të këtyre televizioneve përgjatë një periudhe vrojtimi prej 15 ditësh, (25 nëntor- 10 dhjetor 2016) Gjithashtu, janë analizuar të dhënat e zbardhura nga intervistat me burime pranë këtyre televizioneve.

Hyrje

Kanë kaluar 19 vjet qysh prej datës 25 dhjetor 1995 ku nisi transmetimet e para televizioni Shijak TV. Kjo datë do të shënonte edhe lindjen e televizionit të parë privat në Shqipëri, por njëherazi edhe hapjen e rrugës për lindjen e një sërë televizionesh të reja private në vend.² Qysh prej kësaj date do të vijonin hapjet e televizioneve të reja private dhe lokale vit pas viti. Shqipëria si një vend postkomunist, me ardhjen e demokracisë ka ruajtur modelin e liberalizimit pjesor të tregut, duke e ruajtur televizionin publik. Të njëjtin model gjejmë edhe në mediat lokale të qytetit të Gjirokastrës. Në këtë qytet operojnë tre televizione lokale, nga të cilët dy janë privatë: Channel 7 dhe Alpo tv dhe njëri publik, TVGJ.

Këto televizione që kanë licencë për transmetime lokale shpesh nuk e shohin këtë status edhe të lidhur me përmbajtjen e programacionit të tyre, por vetëm me hapësirat e mbuluara prej tyre. Në fakt, televizionet dhe në përgjithësi gjithë mediat lokale do të

²Megjithëse Shijak TV konsiderohet si televizioni i parë privat në Shqipëri, një studim i Soros-it, thekson se transmetimet e para televizive të një stacioni shqiptar datojnë pak muaj më herët, në mes të vitit 1995, me shfaqjen e logos së Telenorbës Shqiptare me qendër në Bari të Italisë, në ekranet shqiptare, por licensimin e mori në 1996.

duhej të mos u ngjanin mediave kombëtare edhe nga programacioni. Në këto raste do të kishte vend që instanca rregullatore të insistonte më fort që përqindje të konsiderueshme të hapësirave të transmetimit të tyre t'u kushtoheshin problemeve lokale dhe jo atyre kombëtare.

Nuk duhet harruar se vetë media dhe industrializimi i saj lindi si një fenomen i mirëfilltë urban. Është qyteti ai që e ka të pamundur të bazohet më në një komunikim sy më sy, sikur ka qenë karakteristikë e zonave rurale tradicionale. Qyteti është një hapësirë që mbledh çdo ditë e më shumë individë dhe grupe që nuk kanë asnjë njohje me njëri-tjetrin. Metropolet nisin të marrin një shtrirje të tillë gjigante, saqë askush nuk di se çfarë bëhet përtej lagjes së tij, apo edhe më ngushtë sesa atë. Ndërkohë që të gjithë duan të dinë informacione për qytetin ku jetojnë, ku ka punë, ku ka informacione për punë, çfarë ndodhi gjatë ditës, çfarë të rejash ka, dhe mbi të gjitha sesi funksionon demokracia lokale.³

Sërish sipas profesorit dhe studiuesit Artan Fuga: *‘nevoja për informacion lokal urban është, në fakt, kërkesë për të rikrijuar virtualisht lidhjet sociale të shprishura dhe të zbehura fort nga ai që quhet proces atomizimi i shoqërisë urbane. Familja mbyllet disi brenda vetes. Individit e ka të vështirë tanimë që të njohë të tjerët që e rrethojnë në lagjen e tij, në pallatin e tij, apo edhe në zonën e qytetit ku ai jeton.’*

Por për t'u kthyer tek mediat lokale në qytetin e Gjirokastrës të cilat janë objekt i studimit tim, mund të themi se funksionimi i këtyre mediave mbart një sërë problematikash që nga financimi dhe mungesa e subvencionimit e deri tek profesionalizmi i stafit që punon në këto media.

Të ardhurat

Përveç TVGj i cili është televizion publik dhe subvencionohet edhe nga shteti përveç reklamave, dy televizionet e tjerë Tv Alpo dhe Channel 7 mbahen vetëm nga reklamat e pakta lokale me të cilat sigurojnë të ardhurat. Administratori i Tv Alpo, z.Aristotel Petro thekson se është shumë e vështirë që Tv Alpo të mbulojë shpenzimet

³Artan Fuga, 'Nevoja për media lokale', Albeu.com, Tirane, 2011

e punonjësve dhe shpenzimet e tjera vetëm me të ardhurat që siguron nga reklamat. Ai pohon se media që ai drejton nuk është një biznes fitimprurës, por të ardhurat ai i mbulon me biznese të tjera private.⁴ Të njëjtin mendim ndan edhe gazetari i Channel 7, Orgest Sako, i cili kërkon më tepër subvencione nga shteti, pasi të ardhurat që vijnë nga televizioni janë të pamjaftueshme. Pamjaftueshmëria e fondeve dhe subvencioneve ka çuar edhe në mungesë prodhimesh televizive, duke u kufizuar vetëm në lajme lokale dhe lajme kombëtare apo ndërkombëtare të marra nga faqet online dhe rrjetet sociale.

Statusi i gazetarit

Një tjetër problematikë tjetër e këtyre televizioneve janë stafet që punojnë pranë tyre. Radio Televizioni TVGJ, duke qenë se është radiotelevizion publik ka në stafin e tij 21 persona, Tv Alpo ka 5 persona dhe Channel 7 ka gjithashtu 5 persona në staf. Ndërkohë pranë televizioneve private punojnë edhe disa gazetarë me honorare. Ajo që konstatohet është se personat e punësuar si gazetarë nuk kanë përfunduar studimet e larta për gazetari apo shkencë komunikimi. Ata kanë diploma të marra në shkencë shoqërore të marra kryesisht në Universitetin 'Eqerem Cabej' në Gjirokastrë. Kameramanët kanë kryesisht arsim të mesëm. Pagat e gazetarëve në këto televizione vijnë kryesisht 21.000-35000.

Prodhimet televizive

Mungesa e financimeve dhe të ardhurat e pakta që vijnë nga reklamat janë të pamjaftueshme për të prodhuar emisione cilësore apo thjesht larmishmëri programesh. Tv Alpo dhe Channel 7 kanë Webfaqet e tyre në të cilat pasqyrojnë lajmet lokale dhe lajme të tjera ndërkombëtare të cilat i marrin nga mediat online, ndërsa TVGJ nuk ka një webfaqe të tijin. Pasqyrimi i lajmeve lokale në Webfaqen Tv Alpo është i vakët dhe nuk është një faqe e përditësuar me lajmet e fundit, ndërsa trajtimi i tyre nuk është profesional. Lajmet janë të përcipta dhe jo të thelluara. Ndërkohë televizioni Channel 7 ka një

⁴interviste me Aristotel Petro, administrator i Tv Alpo, Gjirokastrë, date 10.12.2016

webfaqe më të përditësuar me lajmet e fundit lokale dhe prek cdo ngjarje lokale që përbën lajm.

Programacionet e këtyre televizioneve kufizohen në edicione lajmesh, filma të marra kryesisht me anë të piraterisë, filma shqiptarë dhe disa emisione si ‘Dritare’, ‘Teleshendeti’, ‘Rubrika sportive’, ‘Oda e miqve’ të cilat janë një tentativë për të zgjeruar gamën e programacionit, por cilësia e emisioneve kushtëzohet nga profesionalizmi i gazetarëve.

Përfundime

- Mediat lokale janë në kushtet e mediave amatore të cilat vijnë si rezultat i mungesës së financimeve.
- Problematikat në këto media vijnë edhe si rezultat i statusit të gazetarit si një punonjës më pagë minimale dhe pa arsimin e duhur në lëmin e gazetarisë apo shkencave të komunikimit si dhe mungesës së trajnimeve.
- Bashkia e qytetit të Gjirokastrës duhet të mendojë për të subvencionuar këto media lokale si edhe të krijojnë stacione radioje ose televizione të tyre apo të subvencionuara prej tyre. Në këtë mënyrë edhe ato ekzistueset do të kenë mundësi të rrisin cilësinë e tyre.
- Instancat rregullatore duhet të ndërhyjnë që këto televizione t’ju kushtojnë një pjesë të rëndësishme të hapësirës së programacionit çështjeve me rëndësi të qarkut që mbulojnë duke shkuar kështu në thellësi të ngjarjeve në mënyrë profesionale.

Bibliografi

- Fuga, Artan, Nevoja për media lokale, Albeu.com, Tirane, 2011
- Luku, Elvin, Lindja e televizioneve private ne Shqipëri, EJO, Tirane, 2013
- Interviste me Aristotel Petro, administrator i Tv Alpo, dt 10.12.2016
- Website i televizionit TV Alpo: <http://alpomedia.com/>
- Website i televizionit Channel 7:<http://www.channel7gjirokaster.com/>